



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

FAST Albania – Finalizohet operacioni policor i koduar “Apartamenti”
DVP Korçë/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 4 të tjerë, për vepra të ndryshme penale
Mali i Tomorrit – Mbi 100 efektivë Policie janë të angazhuar për mbarëvajtjen e pelegrinazhit
Durrës – Goditen 2 raste të tjera të shfrytëzimit të hapësirave publike, si vendparkime automjetesh, me pagesë
Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Game over”



23/08/2023

Korçë – Kapen 2 Shtetas Të Shpallur Në Kërkim Për Një Konflikt Të Ndodhur Më Datë 10.08.2023

Korçë

Tentoi të vriste me armë zjarri një 41-vjeçar dhe kanosi djalin e këtij shtetasi, për shkak të një konflikti ndërmjet tyre, të ndodhur më datë 10.08.2023, kapet dhe vihet në pranga 23-vjeçari i shpallur në kërkim.

Procedohet penalisht vëllai i të arrestuarit, gjithashtu i shpallur në kërkim, si i përfshirë në këtë konflikt.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Korçë, në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Krimeve ndaj Personit të DVP Korçë dhe me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Pogradec, si rezultat i informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, mbi vendndodhjen e 2 shtetasve të shpallur në kërkim për një konflikt të ndodhur më datë 10.08.2023, në lagjen nr. 17, Korçë, kanë bërë të mundur lokalizimin dhe kapjen e tyre.

Për këtë rast u vu në pranga shtetasi M. D., 23 vjeç dhe u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë, për vëllanë e tij, shtetasin Dh. D., 20 vjeç, të dy banues në Korçë.

Nga veprimet e thelluara hetimore ka rezultuar se shtetasi M. D., në bashkëpunim me vëllanë e tij dhe me shtetasin M. S. (i arrestuar nga Policia, më datë 11.08.2023), kanë kanosur shtetasit F. R., 41 vjeç dhe F. R., 22 vjeç (babai dhe djali), për shkak të një konflikti ndërmjet tyre. Gjithashtu, dyshohet se gjatë këtij konflikti, shtetasi i vënë në pranga, M. D. ka qëlluar me armë zjarri, në drejtim të 41-vjeçarit. Nga të shtënat nuk ka shtetas të dëmtuar.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.\

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◄ Mat – Finalizohet faza e 5-të e operacionit antikanabis i koduar “Kreshta të Pastra”

Fier/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale ►